



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1148/1 Prot.

Tiranë, më 11 /08/ 2021

### V E N D I M

**Nr.149 , Datë 11 /08/ 2021**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 145 Regj, datë 02.08.2021, paraqitur nga ankuesi M.K, kundër Bashkisë Vorë, i cili pretendon se është diskriminuar për shkak të “*bindjeve politike*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi M.K parashtron se ka qenë një ish punonjës i Bashkisë Vorë dhe është larguar me pa të drejtë nga puna për shkak të bindjeve politike. Ankuesi ka paraqitur më parë një ankesë pranë institucionit të Komisionerit, në lidhje me këtë shkelje të së drejtës së tij, dhe Komisioneri ka pranuar si të drejtë ankesën, duke i’ a përcjellë vendimin Bashkisë Vorë.

Ankuesi deklaron se, vendimin e Komisionerit për rithimin e tij në punë e ka pranuar edhe Bashkia Vorë, e megjithatë kjo e fundit nuk e ka rikthyer ende ankuesin në punë duke zvarritur kështu të gjithë procesin.

---

<sup>1</sup> Në vijim do t’ i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesi kërkon nga Komisioneri që të marrë masa kundrejt Bashkisë Vorë për të zbatuar vendimin të cilin ajo vetë e ka pranuar.

## II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga aktet e administruara rezulton se, ankuesi M.K, ka depozituar pranë Komisionerit ankesën nr.145 regj., datë 08.08.2021, kundër Bashkisë Vorë, me anë të të cilës kërkon marrjen e masave për zbatimin e vendimit nr.47, datë 17.03.2021, të Komisionerit.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se, ankuesi M.K ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 145 regj., datë 02.08.2021, kundër Bashkisë Vorë, me anë të të cilës ka pretenduar se largimi i tij nga puna kishte ndodhur për shkak të bindjeve politike. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, me vendimin nr.47, datë 17.03.2021, Komisioneri vendosi: “1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit M.K, në të drejtën për punësim, për shkak të bindjeve politike, nga ana e Bashkisë Vorë. 2. Në referim të pikës 1, Bashkia Vorë të marrë masa për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur duke rikthyer ankuesin në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barazvlefshëm me të.”

Me shkresën nr. 2386/1 prot., datë 20.04.2021<sup>2</sup>, Bashkia Vorë, informoi Komisionerin se, kishte vendosur të pranonte vendimin nr. 47, datë 17.03.2021, të Komisionerit, për rikthimin e ankuesit në punë dhe se do të informonte në vijimësi për procedurat, pasi nuk kishin një vend vakant në strukturën organike të institucionit, që përshtatej me arsimimin e ankuesit M.K. Me shkresën nr.711 prot., datë 04.05.2021, Komisioneri ka kërkuar nga Bashkia Vorë, informacion në lidhje me afatin kohor brenda të cilit ajo do të zbatojë vendimin.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose **është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji**; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

---

<sup>2</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr.493/2 prot., datë 23.04.2021.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr.27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Bazuar në kompetencat dhe procedurat e parashikuara nga nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar ankesën për diskriminim të paraqitur nga ankuesi pas largimit të tij nga puna, duke konstatuar diskriminimin e ankuesit dhe duke urdhëruar marrjen e masave nga ana e Bashkisë Vorë për të rivendosur në vend të drejtën e cënuar të ankuesit.

Bazuar në nenin 33, pikat 10 dhe 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “.....10. Komisioneri shprehet me vendim, i cili u njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e regjistrimit të ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. 11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshikimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.....”

Bashkia Vorë ka pranuar vendimin e Komisionerit, duke shprehur vullnetin për zbatimin e tij dhe rikthimin e ankuesit në punë. Por, Bashkia Vorë edhe pse ka pranuar se do të zbatojë vendimin e Komisionerit për rikthimin e ankuesit në punë, nuk ka vendosur asnjë afat kohor në lidhje me përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në vendim.

Rezulton se pretendimi i ankuesit në ankesën e paraqitur, ka të bëjë pikërisht me procedurat që ndiqen nga Komisioneri në lidhje me ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të vendime të dhëna prej tij. Sikurse, pasqyrohet më sipër, Komisioneri ka ndjekur në vijimësi zbatimin e vendimit nga ana e Bashkisë Vorë.

Komisioneri vlerëson se, kërkimi i ankuesit, nuk mund të realizohet nëpërmjet paraqitjes së një ankese, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se : “Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.”, por kërkimi i tij është pjesë e procedurës që ndiqet nga Komisioneri, në zbatim të nenit 33, pika 11, të po këtij ligji.

Në vijim të masave të marra, Komisioneri do të vijojë më ndjekjen e zbatimit të masave të urdhëruara në vendimin e tij nr. 47, datë 17.03.2021, nga ana e Bashkisë Vorë, në zbatim dhe

respektim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës dhe bazuar në neni 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, nenin 33, pikat 1, 4, gërma “b”, 10 e 11 të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës Nr.145 regj., datë 02.08.2021, të paraqitur nga ankuesi M.K kundër Bashkisë Vorë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Shkaku: Bindjet politike

Fusha: punësim

Lloji i vendimit: Mospranim